



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

Njoftim Paraprak Përqendrimi

Rasti: Përfitim Kontrolli Continental Oil & Gas – Stream Oil & Gas Ltd. –
Transatlantic Petrlium Ltd.

Në datën 4 Shkurt 2016, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Memorandumit të Mirëkuptimit” i nënshkruar midis Continental Oil & Gas (Blerësi) dhe Transatlantic Petrlium Ltd. (Shitësi), më datë 14 Janar 2016, me objekt përfitim të kontrollit e plotë dhe të vetëm, nga Continental Oil & Gas të Stream Oil & Gas Ltd. (Targeti), me anë të përfimit të të gjithë kapitalit aksionar në këtë të fundit.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Continental Oil & Gas** : një shoqëri e aksionare e Delaware, me seli në 16192 CoastalHighëay, Lewes, Delaware, USA;
- **Stream Oil & Gas Ltd.:** një shoqëri e themeluar sipas ligjeve te British Columbia, ajo është e angazhuar në aktivitetet e eksplorimit , zhvillimit dhe prodhimit të naftës dhe gazit në Shqipëri;
- **Transatlantic Petrlium Ltd.:** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ofertë publike me seli në Bermuda. Ajo zotëron në Shqipëri degën e saj Transatlantic Albania Ltd.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 2, 10, pika 1, shkronja b), 12, pika 1) të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al